

PROCESVERBAL – Procedure e hapur - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE ESKAVATOR KRAHEGJATE

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
43262100-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

33.330.000 leke pa tvsh

- Afatet e lëvrimet: 90 dite nga lidhja e kontrates

OBJEKTI: BLERJE ESKAVATOR KRAHEGJATE

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr. 301 date 01.09.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Ndermarrja Rruga Durres, me objekt **BLERJE ESKAVATOR KRAHEGJATE**

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, si dhe neni 42 sipas të cilit:

“Në Përlogaritjen e Vlerës Limit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë parasysh;

Çmimet e botuara nga INSTAT- i ose/dhe çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse si psh., nga Organet Tatimore apo Doganore, Dhoma e Tregtisë, në Manuale etj, ose /dhe çmimet e Tregut; ose/ dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga Autoritete të Tjera Kontraktore dhe /ose çmime ndërkombëtare të publikuara

Komisioni organizoi punën për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

- 1. Listat e publikuara** nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
- 2. Institucione të tjera zyrtare** të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbeshtet: Në studimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa subjekteve vendas.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Rruga Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit (Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të çertifikuara/vërtetuara të **bilanceve përvitet 2019,2020,2021** të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet.

b.)Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë duhet të jetë jo më e vogël se **40%** të fondit limit të vlerës së përlllogaritur të kontratës

+1)Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

+2)Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin e nje apo dy viteve nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, nenit 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. *ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës..

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të kategorisë VII.3.B.2 “Licencë për blerjen, shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkio” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Licenca e mësipërme është e lëshuar nga QKL, lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, dhe kërkimi i saj që të zotërohen nga OE pjesëmarrës në procedurë garanton kualifikime dhe cilësi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente e tij. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente e tij. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.6. OE duhet te paraqese katalogun origjinal (ose kopje të noterizuar) perkates, ku te verifikohet qe mjeti i ofruar eshte ne perputhje me specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ilustrojnë mjetet e ofruara prej tyre dhe te vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me te gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

Për punë /mallra/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjëndura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, **bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.